



# Republika e Kosovës


Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për :	<b>Ragip Begaj</b> , Kryetar i Komunës së Malishevës <b>Rrahim Morina</b> , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<b>Adrijana Hodžić</b> , Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal <b>Rozafa Ukimeraj</b> , Sekretare e Përgjithshme në MAPL	<i>[Signature]</i>
Nga:	<b>Venera Çerkini</b> , Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Datë: 24/01/2020 Nr.020-1758/2
Zyrtarët përgjegjës		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	<b>Xhevat Tafa</b> , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	<i>[Signature]</i>
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	<b>Ardita Latifi</b> , Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	<i>[Signature]</i>
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Malishevës	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I/e nderuar Kryetar,  
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore Nr. 02/14 për transparencë në Komunën e Malishevës
E miratuar më datë: 06.01.2020
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 13.01.2020

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Rregullore Nr. 02/14 për transparencë në Komunën e Malishevës	<p>Rregullorja Nr. 02/14 për transparencë në Komunën e Malishevës nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 06/1-081 për qasje në dokumente publike, si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.</p> <p>1) Paragrafi 4 Neni 27 i Rregullores për transparencë të Komunës së Malishevës ka përcaktuar se nuk është në harmoni me paragrafin 1 të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, sipas të cilit: <i>“Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes apo mos përgjigjes së institucionit publik, kërkuesi mund t’i drejtohet me ankesë Agjencisë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje”.</i></p> <p>2) Neni 9 i kësaj Rregulloreje nuk është në pajtim me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, sipas të cilit <i>“në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësia/zyrtari për komunikim publik”.</i></p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration



Za:	<b>Ragip Begaj</b> , gradonačelnik opštine Mališevo <b>Rrahim Morina</b> , predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
Cc:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	<b>Adrijana Hodžić</b> , ministarka administracije lokalne samouprave <b>Rozafa Ukimeraj</b> , generalna sekretarka MALS-a	
Od:	<b>Venera Çerkini</b> , rukovodioca Pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Dana: 24.01.2020 Br.020-1758/2
Odgovorni službenici:		
1. Potvrđeno od:	<b>Xhevat Tafa</b> , rukovodilac Odseka za nadgledanje opština	
2. Izrađeno od:	<b>Ardita Latifi</b> , viša službenica za nadgledanje opština	
Predmet:	Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti akta Opštine Mališevo	
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Uredbe Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsdevajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Uredba br. 02/14 o transparentnosti u opštini Mališevo
Usvojena dana: 06.01.2020. godine.
Dotsavljena MALS-u za razmatranje dana: 13.01.2020. godine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formuliranje u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Uredba br. 02/14 o transparentnosti u opštini Mališevo	<p>Uredba br. 02/14 o transparentnosti u opštini Mališevo nije u saglasnosti sa Zakonom br. 06/I-081 za pristup u javnim dokumentima, kao i Administrativnim uputstvom MALS-a br. 06/2018 o minimalnim standardima javne konsultacije u opštinama.</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1) Stav 4. člana 27. Uredbe o transparentnosti opštine Mališevo utvrdio je da nije u skladu sa članom 20. stav 1. Zakona br. 06 / L-081 o pristupu javnim dokumentima, prema kome <i>U slučaju da je javna institucija u potpunosti ili delimično odbila zahtev za pristup javnim dokumentima ili u slučaju tišine ili ne davanja odgovora os strane javne institucije, podnosilac zahteva može podneti žalbu Agenciji u roku od petnaest (15) dana od prijema odluke za odbijanje ili odluku o delimičnom odobrenju zahteva za pristup “.</i></li><li>2) Član 9. ove uredbe nije u skladu sa članom 8 Administrativnog uputstva MALS-a br. 06/2018 o minimalnim standardima javnih konsultacija u opštinama prema kojima je <i>„u svakoj opštini jedinica / službenik za javnu komunikaciju odgovorna za koordinaciju procesa javnih konsultacija“.</i></li></ol>

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave **traži** od Skupštine opštine/gradonačelnika opštine da preduzmu konkretne mere kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana dostavljanja zahteva za ponovno razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PRIMAR MË  
ACCEPTED ON: 10-01-2020  
TRANSMIT:  
02/14

HYRES-ULAZNA-INCOMING  
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS VLADA-KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Data  
Datum  
Date 13.01.2020

Njësia organizative	Kr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-VI-	020-1758/2		

RREGULLORJA PËR TRANSPARENCË  
NË KOMUNËN E MALISHEVËS

Malishevë  
2020

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja c, nenit 17 shkronja i, nenit 40 paragrafi 2 shkronja a, nenit 58 shkronja h, nenit 68 paragrafi 4, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), dispozitave të Ligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.13/04, korrik 2019), dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/20018 për Transparencë në Komuna, dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/20018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 10, nenit 12, nenit 19 paragrafi 7 pika e, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e - XII- të vitit 2019, të mbajtur me datë:06.01.2020 miraton këtë:

## Rregullore për Transparencë në Komunën e Malishevës

### 1. DISPOZITATE PËRGJITHSHME

#### Qëllimi Neni 1

Më këtë Rregullore synohet që të arrihet:

1. Forcimi i transparencës në punë të organeve të komunës: Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, organeve të administratës, drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punës së ndërmarrjeve publike komunale dhe krijes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal.
2. Zbatimi i praktikave të mira administrative për qasje në dokumente.

#### Fushëveprimi Neni 2

1. Kjo Rregullore rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës.

#### Përkufizimet Neni 3

1. Në hartimin e kësaj Rregulloreje janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:
2. "Mbledhjet e Kuvendit të Komunës" - nënkupton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të këshilltarëve të Kuvendit;
3. "Komitetet" - nënkupton trupa ndihmëse që i ndihmojnë Kuvendit në përmbushjen e përgjegjësiave të caktuara me LVL dhe me Statutin e Komunës;

4. “Pjesëmarrja e publikut” - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje;
5. “Njoftimi i publikut” - nënkupton njoftimin e publikuar në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, publikimin e njoftimeve në gazetën e përditshme dhe në internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të organeve administrative, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale.
6. “Tubime publike” - nënkupton tubimet e organizuara nga organet e Komunës, organet e administratës – drejtoritë, institucionet dhe ndërmarrjet publike lokale, me qëllim të njoftimit për punën e bërë apo dhënien e propozimeve.
7. “Peticioni” - nënkupton kërkesën që i adresohet Komunës nga përgjegjësia e saj.
8. “Konsultim publik i akteve komunale” - nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit.
9. “Qasja në dokumentet zyrtare” - nënkupton shikimin e dokumenteve zyrtare të Komunës, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.
10. “Transparenca” - është veprimtaria e hapur e organeve të komunës që i siguron publikut dhe palëve të interesuara mundësinë e pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës.
11. “Llogaridhënia” – e institucioneve për përgjegjësitë e përcaktuara para qytetarëve për punën e kryer, vendimet e nxjerra si dhe veprimet që janë ndërmarrë.
12. “Vendim” – nënkupton aktin normativ që nxirret nga organi kompetent komunal dhe në kuadër të autorizimeve të dhëna në bazë të ligjit dhe me të cilët vendoset për çështje, për të cilat kërkohet një vendim i organit përkatës.
13. “Kërkuesi i dokumentit” – çdo person fizik apo juridik, pa diskriminim në çfarë do lloj baze, në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (në tekstin e mëtejshëm: kërkuesi)

#### Mbledhjet e Kuvendit të Komunës Neni 4

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun dhe për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës njofton publikun për mbajtjen e mbledhjeve përmes Zyrës për Marrëdhënie me Publikun, të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhje urgjente brenda ditës.
3. Njoftimi publik bëhet përmes:
  - medieve të shkruara dhe elektronike dhe
  - ueb-faqes së Komunës.
4. Njoftimi me shkrim për publikun përmban: (I) datën e mbajtjes së mbledhjes, (II) kohën e mbajtjes së mbledhjes, (III) vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe (IV) rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.
6. Të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të bëhen publike pas konfirmimit të ligjshmërisë së tij dhe shtatë (7) ditë pune pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.
7. Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës publikohen në ueb-faqen e Komunës së Malishevës.
8. Transmetimi i seancave të KK, të bëhet në ueb-faqe të komunës dhe brenda mundësive

buxhetore në një televizion lokal, dhe të ruhet në arkivin e faqes video-incizimet e mbledhjeve.

9. Votimi të bëhet publik për të gjitha vendimet e Kuvendit të Komunës, me emër dhe mbiemër të anëtarëve të Kuvendit.

### **Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetet tjera Neni 5**

1. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera mund të jenë të mbyllura për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Vendimin për këtë e merr kryesuesi i mbledhjes.
  - a. Zyra për Komunikim me Publikun njofton mjetet e informimit publik 7 (ditë) para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimi duhet të përmbajë: datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
  - b. Të gjitha propozimet e komiteteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare, duhet të jenë në dispozicion për publikun sipas kërkesës.

### **Peticioni Neni 6**

1. Secili qytetar dhe personi juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetiniciativë, përmes formës së peticionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për qytetarët e komunës.
2. Subjektet e përmendura më lart, mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij, në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:
  - a) rregullimin e qytetit,
  - b) mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës - qytetit,
  - c) urbanizimin e qytetit dhe të fshatit,
  - d) mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,
  - e) zbatimin e vetëkontrollit dhe
  - f) çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.
3. Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes zyrës së drejtorit të Drejtorisë së Administratës.
4. Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.
5. Qytetarët mundë të marrin një iniciativë për të propozuar një rregullore brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi. Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, dhe duhet të nënshkruhet nga 15% të votuesve të regjistruar për tu shqyrtuar nga kuvendi komunës. Neni 69 dhe 70 i ligjit nr.03/L-040 paragrafi 1,2,3 të ligjit për Qeverisje Lokale.
6. Kur një peticion nënshkruhet nga më shumë se 10% qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjë me çështjet që janë të lidhura me qytetin, Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë çështjen. Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatra apo lagje të caktuara, peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës, nëse atë e nënshkruajnë



së paku 10% qytetarë të regjistruar në listën e votuesve, banorë të atij fshati apo të asaj lagjeje.

7. Nëse një fshat, vendbanim apo lagje, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë mbi 100 banorë, të regjistruar në regjistrat e votuesve. Nëse për një çështje në nivel të komunës duhet së paku ta nënshkruajnë 500 qytetarë më të drejtë vote dhe që janë të regjistruar në listën e votuesve të Komunës së Malishevës, që peticioni të jetë i plotfuqishëm juridikisht.
8. Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të ceket qartë në secilën faqe. Komunitetet mund t'i bëjnë peticione Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë ashtu siç është cekur më lart. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.
9. Drejtori i Drejtorisë së Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm, ia prezanton Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të peticionit.
10. Vendimin përfundimtar për kërkesat dhe iniciativat qytetare si dhe peticionet duhet të shqyrtohen nga kuvendi komunal brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetditësh), të përcaktuar në nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 03/L-040 për Qeverisje Lokale si dhe neni 16 paragrafi 4.

### **Takimet me publikun** Neni 7

1. Komuna/Kryetari organizon takime publike periodike me qytetarë së paku dy herë në vit.
2. Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunalë i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.
3. Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.
4. Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
5. Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.
6. Njëri tubim duhet të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë.
7. Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy takime me qytetarë, atëherë ndërmjet këtyre mbledhjeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku tre muajsh.
8. Tubimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara.
9. Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtes/ën-at e Komunës dhe në vendet më të frekuentuara në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës në mediet e shkruara dhe elektronike përfshirë dhe mediet lokale, dhe atë 14 ditë para mbajtjes së tubimit. Shpalljen publike e bën Zyra për Komunikim me Publikun.
10. Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës, dhe janë të obliguar të marrin pjesë zyrtarë më të lartë të komunës si: Kryesuesi i Kuvendit, drejtorët e drejtorive, kryetarët e komiteteve dhe zyrtarët kompetentë për çështje në diskutim publik.

11. Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.
12. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.
13. Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.
14. Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e radhës.

### Konsultimi publik i akteve komunale

#### Neni 8

1. Rregulloret dhe dokumentet me interes të përgjithshëm të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.
2. Zyra përgjegjëse për informim, njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për diskutim publik, përmes:
  - a) shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
  - b) medieve të shkruara dhe
  - c) ueb faqes së Komunës në internet.
3. Njoftimi publik, sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje.
4. Organi kompetent që ka propozuar aktin, duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqarojë përmbajtjen e aktit para publikut.
5. Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidencohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve.
6. Organi që ka propozuar aktin, duhet të informojë Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

## **Caktimi i zyrtarit përgjegjës** **Neni 9**

Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është propozuesi i dokumentit të caktuar dhe njësia/zyrtari për komunikim publik.

## **Parimet e konsultimit publik** **Neni 10**

1. Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin e:

1.1. **Ligjshmërisë** - duke siguruar se procesi i konsultimit publik zhvillohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme brenda kompetencave komunale.

1.2. **Transparencës** - që nënkupton një qasje e hapur e komunës për të garantuar se qytetarët dhe palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhët zyrtare.

1.3. **Barazisë dhe mosdiskriminimit** - në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të kenë qasje të barabartë dhe jodiskriminuese në procesin e konsultimit publik.

1.4. **Efikasitetit në procesin e konsultimit publik** - duke mundësuar aplikimin e formave dhe teknikave më të përshtatshme për të kuptuar më lehtë përmbajtjen dhe ndikimin e pritur të projekt- propozimeve.

## **Dokumentet për konsultim publik** **Neni 11**

Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim:

1. Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës / ekzekutivit.
2. Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor.
3. Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme.
4. Strategjitë zhvillimore dhe Planet e veprimt në nivel lokal në kuadër të fushave sektoriale.

5. Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor.

6. Të gjitha dokumentet e tjera për të cilat komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik.

7. Çfarëdo dokumenti tjetër të paraparë në legjislacionin e zbatueshëm që duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

### **Format dhe teknikat e konsultimit publik**

#### **Neni 12**

1. Publikimet dalin edhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë, të integruar si vegëza në ueb-faqen zyrtare të komunës;

#### **Neni 13**

### **Planifikimi i konsultimeve publike**

1. Planifikimi i përgjithshëm i konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendariq si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim publik.

### **Zbatimi i standardeve të konsultimit publik**

#### **Neni 14**

1. Komuna bën publikimin e projekt-propozimeve në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe në Platformën e Konsultimeve Publike në nivel Qendror.

2. Projekt-propozimet të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.

3. Komuna për politikat e caktuara të parapara në legjislacionin në fuqi, duhet të siguroj konsultimin në fazat e hershme të hartimit dhe palët e interesuara që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes.

4. Komuna është e obliguar të shpall rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jep sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara.

### **Aktet nënligjore të komunës për konsultim publik**

#### **Neni 15**

1. Aktet e komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:
  - 1.1 Draft-Statuti i Komunës.
  - 1.2 Projekt-rregulloret komunale.

1.3 Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale.

### **Mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik**

#### **Neni 16**

1. Kryetari i Komunës siguron që projekt propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i përmbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
2. Kuvendi i Komunës refuzon aprovimin e projekt propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kritereve të përcaktuara me udhëzimet administrative.

### **Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi**

#### **Neni 17**

1. Komuna obligohet të koordinohet me MAPL dhe me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, për ngritjen e kapaciteteve të zyrtareve komunal për konsultim publik.

### **Transparenca e vendimeve të organeve të komunës**

#### **Neni 18**

1. Publikimi në faqen zyrtare të komunës i akteve normative të komunës me karakter të përgjithshëm është i obligueshëm në afat prej 7 dite pune nga konfirmimi i ligjshmërisë së vendimit.
2. Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës pas nënshkrimit dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë publikohen në faqen zyrtare të komunës.
3. Aktet normative dhe vendimet e organeve të komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në faqen zyrtare të komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësia/zyrtari përgjegjës/e për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të komunës.
4. Në panelet intervistuese për pranimin e punëtorëve në sektorin publik, të mundësohet pjesëmarrja në cilësinë e vëzhguesve edhe palëve të tjera si: OJQ, ekspert të fushave përkatëse dhe qytetarë të tjerë.
5. Në ueb faqen e komunës të publikohen të gjitha vendimet e Kryetarit të komunës. të Kuvendit Komunal dhe të KPF-së.

## **Transparenca financiare**

### **Neni 19**

1. Komuna obligohet në transparencë të planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore duke ndërmarrë veprime konkrete në publikimin e tyre në faqen zyrtare të komunës.
2. Planin e buxhetit pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
3. Raportet tre mujore financiare sipas afateve të parashikuara me legjislacion sektorial.
4. Komiza Afatmesme Buxhetore (KAB) pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës.
5. Raporti përmbledhës financiar për vitin e kaluar fiskal sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin sektorial.
6. Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.
7. Njoftimet publike nga komuna siç janë: Dëgjimet publike për buxhetin, konkurset dhe shpalljet, përveç në ueb faqen e komunës duhet të publikohen edhe në tabelat e shpalljeve dhe mediet e shkruara, përfshirë edhe mediet lokale.

## **Transparenca në aktivitetet e prokurimit**

### **Neni 20**

1. Komuna publikon në faqen zyrtare elektronike çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial.
2. Komuna publikon planin dhe raportin e prokurimit në faqen zyrtare elektronike, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin sektorial.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit Publik t'i bëjë publike në Zyrën për Informim të gjitha njoftimet dhe kontratat e lidhura me operatorët ekonomik.

## **Qasja e drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike**

### **Neni 21**

1. Komuna siguron qasje në informata dhe dokumente publike përmes faqes zyrtare të saj, si:
  - 1.1 Planin e Punës së Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës.
  - 1.2 Planin për Konsultim Publik.
  - 1.3 Planin për Komunikim Publik.
  - 1.4 Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave të miratuara.
  - 1.5 Planin Zhvillimor Komunal, Hartat zonale dhe planet rregulluese urbane.
  - 1.6 Raportin vjetor të punës së Kryetarit dhe Kuvendit.
  - 1.7 Procesverbalet e takimit të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve obligative.
  - 1.8 Të dhënat për biografitë e udhëheqësve të lartë të organeve të komunës dhe anëtarëve të KK-ve.
  - 1.9 Emrin, numrin e telefonit zyrtar dhe adresën e e-mail-it të drejtuesve të njësive brenda institucionit.
  - 1.10 Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen edhe

1.10.1 Procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre

1.10.2 Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar.

### **Hartimi i Planeve Vjetore të Punës në Komuna Neni 22**

1. Komunitat obligohen që të hartojnë Planet Vjetore të Punës së Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit.

2. Në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Komuna obligohet të hartoj Planin për Komunikim me Publik dhe Planin për Konsultim me Publikun.

### **Format e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje Neni 23**

1. Komuna siguron mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në çdo fazë të procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave lokale, duke filluar nga:

1.1. Planifikimi

1.2. Diskutimi

1.3. Marrja e vendimit

1.4. Implementimi dhe

1.5. Monitorimi

2. Mekanizmat e lartpërmendura duhet të shfrytëzohen më qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, si:

2.1 Informimi me kohë dhe komunikimi, përmes së cilëve qytetarët do të mund të shprehin sugjerimet, kërkesat dhe vërejtjet e tyre.

2.2 Përfshirjen e qytetarëve në grupet punuese.

2.3 Organizimi i takimeve periodike me qytetarë në fshatra dhe lagje.

2.4 Themelimi i Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, në veçanti për planifikimin hapësinor dhe buxhetin.

2.5 Fuqizimi i bashkëpunimit mes Komunës dhe shoqërisë civile.

3. Duke promovuar qeverisje të mirë, komunitat inkurajojnë personat me nevoja të veçanta të moshuarit, minoritetet, të rinjtë dhe gratë, për përfshirje në procesin e vendimmarrjes duke gjetur forma dhe mekanizma shtesë.

### **Plani i veprimit për transparencë në komuna Neni 24**

1. Komuna obligohet të hartoj planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë në komunë, dhe pas miratimit në Kuvendin e Komunës, i njëjti publikohet në faqen zyrtare të komunës.

2. Plani i veprimit për transparencë në komunë, ka për synim t'i ofrojë publikut qasje në

monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.

### 3. Plani duhet të përfshijë:

- 3.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës.
- 3.2 Mbledhjet e Komiteteve.
- 3.3 Takimet publike.
- 3.4 Takimet konsultative.
- 3.5 Takimet obligative në media për çështje që lidhen me shfrytëzimin e buxhetit të komunës.
- 3.6 Shpalljet publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit administrativ të komunës.
- 3.7 Takimet me grupet e interesit për të diskutuar çështje të sigurisë në bashkësi.
- 3.8 Qasje të shpejtë dhe transparente të shërbimeve për qytetarët.
- 3.9 Procedurat transparente të Prokurimit.
- 3.10 Procedurat transparente të punësimit.
- 3.11 Publikimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare.
- 3.12 Përfshirja aktive e qytetarëve në vendimmarrje.

## Gjuhët për komunikim zyrtar Neni 25

1. Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhët e tyre, në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të Komunës. Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehen në gjuhët e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.
2. Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të Këshillit të Drejtorëve dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të bëhen në të dy gjuhët, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
3. Aktet normative të Komunës shtypen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga organet e administratës, jepen në gjuhën e palës. Gjuhë e palës konsiderohet gjuha në të cilën pala fillimisht i drejtohet Komunës.
4. Rregulloret komunale dhe vendimet mund të shtypen edhe në gjuhën e një komuniteti tjetër, nëse ai komunitet e kërkon atë.
5. Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
6. Komunikimi me institucionet komunale, institucionet e Republikës së Kosovës dhe organet e organizatat tjera, mund të bëhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
7. Çështjen e përdorimit të gjuhëve, Kuvendi i Komunës e rregullon me rregullore për gjuhët.



## **E drejta e publikut për qasje në dokumente zyrtare të Komunës**

### **Neni 26**

1. Cilido person fizik apo juridik ka të drejtë në qasje të dokumenteve të organeve komunale, duke ju nënshtruar Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Qasjen në Dokumente Zyrtare dhe Statutit të Komunës së Malishevës.
2. Kjo Rregullore vlen për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të Komunës, të hartuara apo të pranuar nga këto organe, për të gjitha fushat dhe aktivitetet e Komunës, nëse me ligj nuk është e rregulluar ndryshe.
3. Personat fizik dhe ata juridik, nga paragrafi 10.2 të këtij neni, e gëzojnë të drejtën të jenë të informuar për politikën, vendimet dhe punën e organeve të Administratës komunale.

## **Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare**

### **Neni 27**

1. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare parashtrohet në formë të shkruar, duke u përshkruar informacioni që kërkohet, në mënyrë që Komuna ta identifikojë dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar t'i japë arsyet për parashtrimin e kërkesës.
2. Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur me informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën.
3. Nëse organet e komunës, nuk e posedojnë dokumentin e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës, obligohen që në afat prej 5 ( pesë ditë) pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim, t'ia përcjellin kërkesën organit përkatës.
4. Organet kompetente komunale e kanë për obligim që në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës, t'i kthejnë përgjigje me shkrim parashtruesit të kërkesës. Nëse kërkesa refuzohet, pala e pakënaqur me përgjigjen ka të drejtë ankesë. Ankesa i dorëzohet Komisionit të ankesave, i cili duhet ta miratojë ose ta refuzojë ankesën në afat prej 15 ditësh.
5. Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike mund të vazhdohet deri në 15 (pesëmbëdhjetëditë), në qoftë se dokumenti publik kërkohet jashtë organeve të komunës, dhe nëse përmes një kërkesë kërkohen disa dokumente publike.
6. Nëse organet komunale nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi ka të drejtë ta ushtrojë kërkesën konfirmuese. Në rast se kërkesa konfirmuese refuzohet plotësisht apo pjesërisht, organi komunal kompetent e njofton parashtruesin me mjete ligjore që i ka në dispozicion ai/ajo (nisja e procedurës gjyqësore ose parashtrimin e ankesës tek Zyra e Avokatit të Popullit).

## **2. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 28**

#### **Epërsia me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore**

Në rast konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregullore dhe në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit nr.06/L-081

për Qasje në Dokumente Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.13/04, korrik 2019), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/20018 për Transparencën në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/20018 për standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

**Neni 29**  
**Ndryshimi dhe Plotësimi**

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, me propozimet e arsyetuara nga propozuesi.

**Neni 30**  
**Zbatimi i Rregullores**

Për zbatimin e kësaj Rregullore përgjegjës është Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë Komunale.

**Neni 31**  
**Shfuqizimi**


Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja për Transparencë nr.02-385 e datës 23.12.2016, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

**Neni 32**  
**Hyrja në fuqi**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008). nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS**

Kuvendi i Komunës  
Nr.02/14  
Datë: 10.01.2020



## Ardita Latifi

---

**From:** Majlinda Shaqiri  
**Sent:** Friday, January 24, 2020 9:21 AM  
**To:** Ardita Latifi  
**Cc:** Xhevat Tafa; Nazmije G.Krasniqi  
**Subject:** FW: Rregullore për transparencë\_Malishevë  
**Attachments:** Opinion ligjor\_Malisheve 22 01 2020\_finale.docx

---

**From:** Diellor Gashi  
**Sent:** Friday, January 24, 2020 9:13 AM  
**To:** Majlinda Shaqiri  
**Cc:** Nazmije G.Krasniqi  
**Subject:** RE: Rregullore për transparencë\_Malishevë

Majlinda

Procedoje per Departament Ligjor kete version

---

**From:** Nazmije G.Krasniqi  
**Sent:** Friday, January 24, 2020 8:28 AM  
**To:** Diellor Gashi  
**Subject:** FW: Rregullore për transparencë\_Malishevë

Drejtor

Kjo rregullore është adresuar ne divizioni e transparencës me datën me 15.01.2020 ndërsa ne DLM me datën 13.01.2020 , unë e kam adresuar edhe fizikisht te ju me datën 22.01.2020 , do te ishte mire qe te kthejmë përgjigjen ne DLM qe mos te vonohem ne përgjigjen

---

**From:** Nazmije G.Krasniqi  
**Sent:** Wednesday, January 22, 2020 2:50 PM  
**To:** Diellor Gashi  
**Subject:** FW: Rregullore për transparencë\_Malishevë

I nderuari

Te bashkangjitur keni vlerësimin për komunën e Malishevës do ta dërgojmë edhe fizikisht tani

---

**From:** Ardita Latifi  
**Sent:** Wednesday, January 15, 2020 10:39 AM  
**To:** Nazmije G.Krasniqi  
**Cc:** Xhevat Tafa  
**Subject:** Rregullore për transparencë\_Malishevë

E nderuar,

Bashkëngjitur gjeni Rregulloren per transparencë, nga komuna e Malishevës, e miratuar me datë 06.01.2020.

Të lutem, e shikoni Ju si Div. kompetent, a është në rregull?

Faleminderit shumë!



**Ardita LATIFI**

*Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave*

*Qeveria e Republikës së Kosovës/Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ndërtesa e Qeverisë "ish-Rilindja", kati 11, zyra 11/17*

*Email: [ardita.latifi@rks-gov.net](mailto:ardita.latifi@rks-gov.net)*

*Nr. Centrix: 038-200-35-629*

*Prishtina, Republika e Kosovës*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

<b>REFERENCË:</b>					
<b>PËR/ZA/TO:</b>		Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave			
<b>CC:</b>		Venera Kosumi, Udhëheqëse e DLMKsë			
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>		Diellor Gashi, Udhëheqës i DPTK-së			
<b>NGA/OD/FROM:</b>		Nazmije Krasniqi, Udhëheqëse e Divizionit për transparencë			
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>		Opinion ligjor për Rregulloren për Transparencë të Kuvendit të Komunës së Malishevës me Nr.V/020-1758/13.01.2020 .			
<b>Nr. i zyrës:</b>	1117	<b>Lokacioni:</b>	<b>Ndërtesa</b>	<b>Data:</b>	
<b>Br. kancelarije:</b>		<b>Kucni:</b>	ish-"Rilindja"	<b>Datum:</b>	22.01.2020
<b>Room No.:</b>		<b>Extension:</b>		<b>Date:</b>	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
<b>AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE</b>					

Në bazë të kërkesës së Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave të dërguar me datë 15.01.2020, Divizioni për Transparencë ka shqyrtuar Rregulloren për Transparencë të Kuvendit të Komunës së Malishevës e protokoluar në MAPL me datë 13.01.2020 . Nr. VI 020- 0-1758/2.

Divizioni për Transparencë Komunale, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2018 për Transparencën në Komuna, Rregulloren Nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale , Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, konstaton se:

- 1) Paragrafi 4 i nenit 27 të Rregulloreve për transparencë të Komunës së Malishevës ka përcaktuar se nuk është në harmoni me paragrafin 1 të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, sipas të cilit *“Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes apo mos përgjigjes së institucionit publik, kërkuesi mund t’i drejtohet me ankesë Agjencisë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje”*.
- 2) Neni 9 i kësaj Rregulloreje nuk është në pajtim me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, sipas të cilit *“në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njëzia/zyrtari për komunikim publik”*.

Duke marrë parasysh konstatimet e përmendura më lartë, Divizioni për Transparencë jep opinion negativ lidhur me ligjshmërinë e Rregulloreve për Transparencë të Komunës së Malishevës, duke rekomanduar që Departamenti Ligjor i MAPL-së të parashtoj kërkesë për rishqyrtim dhe harmonizim me dispozitat ligjore për transparencë në fuqi.